



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

IShP – Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

GRUPI NË SHQIPËRI PËR SEZONIN 2018-2019 JAVA 50 (10-16 DHJETOR)

Buletini i Gripit nr.4

24 Dhjetor 2018

PËRMBLEDHJE

Në këtë vëllim:

Përmbledhje	1
Prirja e IRS dhe IRP	3
Frekuenca e hasjes	3
Nr total i mostrave	4
Viruset e tjerë	5
Shpërndarja moshore	6
STRRA	7
STRRA moshore	8
IRA-pragu	11
Kurba epidemike	12
Info nga TESSY	13

Informacion kyç:

- Situata ne EURO-TESSY
- Përbërja e vaksinës
- STRRA

Përmbledhje

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se kemi një prirje në rritje të infeksioneve respiratore paraqet rritje në javën 50/2018 por aktiviteti i tyre në lidhje me gripin mbetet i ulët.

Kontinenti European

Në javën 50/2018 në kontinentin European aktiviteti i gripit në Evropë është ende i ulët dhe vetëm 3 vende raportuan intensitet mesatar.

Në këtë javë 193 (18%) nga 1059 mostra të marra nga survejncat sentinel janë konfirmuar me virusin e gripit nga të cilat 190 (98.4%) ishin të tipit A and 3 (1.6%) të tipit B. **Nga nentipizimi i viruseve të tipit A, rezultojnë nentipet A (H1N1)pdm09 (52.2%) dhe A (H3N2) (47.8%).**

Që nga fillimi i sezonit mbizoterojnë viruset e tipit A (n = 521, 96.5%) krahasuar me viruset e tipit B (n = 19, 3.5%). Nga 496 viruset e tipit A, 274 (55.2%) ishin A (H1N1) pdm09 dhe 222 (44.8%) ishin A (H3N2). Nga genotipizimi i 5 viruseve të tipit B, 4 ishin të linjës B / Yamagata dhe 1 ishte B / Victoria.

Nga survejanca jo-sentinel kanë rezultuar 1289 mostra positive për virusin e gripit nga të cilat 96.6% janë të tipit A dhe 3.4% janë të tipit B. Mbas nëntipizimit të viruseve të tipit A 69.5% rezultuan A(H1N1)pdm09 dhe 30.5% A(H3N2). Nga genotipizimi, viruset e tipit B rezultuan të linjës B / Yamagata.

Të dhënat nga 22 vende që raportojnë në projektin EuroMOMO treguan se vdekshmëria nga të gjitha shkaqet ishte në nivele të ulëta dhe të pritshme për këtë kohë të vitit.

Rekomandimet e OBSH-së mbi përbërjen e vaksinës së gripit për Hemisferin Verior gjatë sezonit 2018 - 2019 janë:


A/Singapore/INFIMH-16-0019/2016 (H3N2)-like virus;
B/Colorado/06/2017-like virus (B/Victoria/2/87 lineage);
A/Michigan/45/2015 (H1N1)pdm09-like virus;

dhe për vaksinë quadrivalente:

B/Phuket/3073/2013-like virus (B/Yamagata/16/88 lineage)


Në bazë të analizimeve të thelluara filogjenetike të viruseve të dërguara nga Qendra Kombetare e

1. PËRQINDJA E MOSTRAVE RESPIRATORE QË KANË REZULTUAR POZITIVE PËR VIRUSET E GRIPIT, SIPAS KONTINENTEVE




2. PRIRJA E INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP) NË JAVËT 40 – 50 TË VITIT 2017 DHE TË VITIT 2018.

NUMRI I RASTEVE.




Në javën e 50 të vitit 2018 vërehet një trend në rritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 8% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

3. FREKUENCA E HASJES SË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME DHE TË POSHTËME” SIPAS RRETHEVE NË JAVËN 49 DHE 50 TË VITIT 2018. INCIDENCA (RASTE/10.000)



Vërehet rënie e numrit të rasteve të IRA në disa rrethe të vendit

4. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK



Prej javes 40 (1 - 7 Tetor 2018) deri ne javen 50 (10 - 16 Dhjetor) jane grumbulluar 116 mostra nazofaringeale nga qendrat e survejances ILI dhe SRRA apo STRRA.


Perpara pranimit në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilësisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR.

Nga testimi i tyre nuk është identifikuar asnjë rast pozitiv për virusin e gripit.

Sipas algoritmit të testimit, rastet negative për grip testohen per viruse të tjera respiratore me anë të metodës molekulare.

5. REZULTATI I TESTIMIT PËR VIRUSE TË TJERË RESPIRATORË


Më poshtë paraqiten rezultatet për javët 40 deri 49. Vëmë re se për javën e 49, nga numri total i mostrave të grumbulluara dhe analizuara, 10 (47.6%) kanë rezultuar pozitive për viruse të ndryshëm respiratorë. Virusi respirator sincicial perben virusin kryesor respirator të izoluar gjatë këtyre javëve.



SHPËRNDARJA E REZULTATEVE PËR JAVËT 40 DERI 49


LLOJI I VIRUSEVE TË TJERË RESPIRATORË

Viruset të tjera respiratore	ava									(%Poz)
	40	42	43	44	45	46	47	48	49	
Rhinovirus -				1	1				1	3.2
Coronavirus 43-		1	1		3	2				7.4
Coronavirus 63	2			1					2	5.3
Coronavirus 229	1									1.1
Virusi respirator sincicial-		2		2	1		2	3	4	14.7
Parainfluenza tip-2			1							1.1
Parainfluenza tip 3-					1				2	3.2
Parainfluenza tip 4						1				1.1
Bocavirus					-	-	-	1		1.1
Enterovirus			2							2.1
Metapneumovirus			1						1	2.1
Negative	0	1	5	5	10	10	7	6	11	57.9
Total	3	4	11	9	15	13	9	10	21	100.0

6. SHPËRNDARJA E NUMRIT TOTAL TË RASTEVE SIPAS GRUP-MOSHËS

38 (33%) e mostrave i perkasin grupmoshes pediatrike 0-14 vjeç por verehet se nga grup mosha 5-14 vjec numri i mostrave mbetet i ulet.


7. SËMUNDJE E TEPËR E RËNDË RESPIRATORE AKUTE (STRRA)




Rasti klasifikohet si SRRRA (Sëmundje e rëndë respiratore akute) sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.

25 (37%) prej 68 pacientëve spitalorë kanë paraqitur komplikacione (STRRA)

8. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRRA DHE STRRA SIPAS JAVËVE






9. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRA SIPAS GRUPMOSHËS




5 (12%) e mostrave SRRA i perkasin grupmoshes pediatrike 0-14 vjeç

10. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS




11. SHPËRNDARJA E RASTEVE STRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS**12. SHPËRNDARJA RASTEVE STRRA SIPAS GRUPMOSHËS DHE REZULTATI LABORATORIK**

18 (72%) e mostrave STRRA i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç

13. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK

Numri më i madh i mostrave ka ardhur nga Qendra Shendetesore Nr. 2, ndjekur nga SUSM.


14. KRAHASIMI I AKTIVITETIT TË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP)” SIPAS SEZONEVE (JAVËT 40 – 20) DHE PRAGU EPIDEMIK. RASTE/100 000



Në javën 50/2018 aktiviteti i IRA paraqet:

- prirje në ritje
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt të ulët

15. KURBA EPIDEMIKE DHE INFEKSIONET RESPIRATORE SIPAS JAVËVE (IRA RASTE/100 000)





Vërehet që trendi i mostrave të marra ndjek trendin e Infeksioneve respiratore (IRA)



16. INTENSITETI DHE PËRHAPJA GJEOGRAFIKE E GRIPIT DHE VIRUSET QË QARKULLOJNË NË RAJONIN EUROPIAN NË JAVËN 50.

<http://flunewseurope.org/>



**Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

Adresa:
Rr. "A. Moisiu" Nr. 80
Tiranë

Tel: + 355 42 374 756
Fax: + 355 42 370 058
www.ishp.gov.al
